



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01- 2083/20
Kaçanik, 27.01.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-r (Parë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 27 Janar 2020. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës –Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive; Ramadush Osmani, Zahir Doda.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I-r (Parë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 27 Janar, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 12 e KPF, të datës 23 Dhjetor 2019;
2. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020;
3. Raport (Informatë) i punës së Njësisë së Përsoneelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019;
4. Informatë e DAK për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020;
5. Propozim Vendimi për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;
6. Plani strategjik i veprimit të Grupit të Grave për vitin 2020;
7. Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, për vitin 2020;
8. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019; dhe
9. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2019.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin;

z. Selim Reka, Për mbledhjen e Kuvendit të Komunës janë propozuar me tepër pikë sesa për mbledhje të KPF, ku është arsyeja?

Kryesuesi i Kuvendit, Në mbledhje të KK ka me tepër pikë sepse disa pikë nuk shkojnë përmes procedurës së KPF, si: Leximi i dytë i Rregullores për bashkëpunimin e komunës me lagje e fshatra, Informata e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për aktivitetin e KK në vitin 2019; dhe Plani i Punës së KSHP. Unë jam që në këtë mbledhje të fusim në rend pune çështjen e kompensimit të komisioneve të KK.

z. Ekrem Kyçyku, Propozoj që çështja e kompensimit të komisioneve të KK të debatohet në mbledhjen vijuese të KPF, pasi të përgatitet materiali për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë, çështja e kompensimit të komisioneve të KK të debatohet në mbledhjen vijuese, ndërkaq, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është njëzëri me punuar me këtë rend pune. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së XII-të (Dymbëdhjetë) të Rregullt të KPF-a, mbajtur me datë 23 Dhjetor 2019 / Lënda: 01Nr. 060/03-39481/19.

2. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush di\ka me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Në Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020 janë paraqitur objektivat në secilin sektor, ndërkaq uroj që këto objektiva të realizohen për gjatë vitit 2020.

z. Ekrem Kyçyku, Në Planin e punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2020 shihet së janë përshkruar punët dhe detyrat e punës rutinore që kanë sektorët, ndërkaq shumë pak ka objektiva të planifikuara. Ky Plani pune shihet së është identik me atë të vitit 2019, vetëm se iu ka ndërruar radhitja disa drejtorive. Të DSHMS, të objektivat e këtij sektori, në kuadër të objektivës me Nr. 1 është, Disiplina në punë duke filluar nga drejtori deri të

portiri. Kjo nuk është objektivë. Kjo është obligim që duhet me u respektuar nga secili i punësuar.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Objektivat është e vërtetë se janë të njëjta, sepse punët që kanë me u kryer në Shërbimin Civil janë të njëjta-punë rutinore, ndërkaq nëse del ndonjë objektivë tjetër jashta këtyre që janë shënuar në këtë plan, ajo çështje do të shqyrtohet si e veçantë, ndërkaq sesa do të zbatohen objektivat, është diçka tjetër. Kemi objektiva që nuk i kemi pasur në vitet tjera, tani i kemi, si; çështjen e pajisjes së shkollave me kabinete e kështu me radhë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky plan t'i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim. KPF u pajtua njëzëri që planin e punës së Ekzekutivit të Komunës t'ia kalojë KK në procedurë për shqyrtim. Në sajë të kësaj del konstatimi se,

KPF e shqyrtoj Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020 dhe i njëjti i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.

3. Raport (Informatë) i punës së Njesisë së Përsoneelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e shqyrtoj Raport (Informatë) i punës së Njesisë së Përsoneelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019 dhe të njëjtën ia kalon KK në procedurë për shqyrtim.

4. Informatë e DAK për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Informata për aktivitetin e shkollave në periudhën e parë të vitit shkollor 2019/2020 është mirë e punuar mirë, është paraqitur në formë të drejtë gjendja e shkollave të komunës. Shqetësuese për ne është, numri i mungesave të nxënësve dhe i arsimtarëve në të gjitha shkollat, pavarësisht se ka edhe mungesa me arsye për shkaqe të ditura. Tjetër, shqetësuese është zvogëlimi i numrit të nxënësve nga viti në vit për shkak të migrimit të familjeve jashtë vendit apo regjistrimit të nxënësve në komunat tjera për shkak të afërsisë apo të drejtimeve. Nëse vazhdohet ky trend, atëherë paralelet në shkollat tona dita ditës shihet se po shkojnë drejt shuarjes. Rëndësi të veçantë në vitin 2020 duhet me iu kushtuar çështjes së arsimit në; rregullimin e ambientit në disa shkolla, pajisjen e shkollave me kabineteve, teknologji informative etj.. Kur jemi të pajisja e shkollave me kabinete, shkolla e mesme "Skënderbeu" në Kallanik, është një klasë e lirë, e cila mundet me u përdorur për kabinete.

z. Ekrem Kyçyku, Informata është e hartuar mirë si dokument, ndërkaq sa i përket të dhënave të paraqitura, shqetësuese është mungesa e madhe e nxënësve dhe arsimtarëve të cilën e potencoj edhe z. Selim Reka. Në shkollat fillore, nga të dhënat e paraqitura në informatë, shihet se është shumë e madhe nota mesatare. Ky rezultat i nxënësve kaq i madh i notës mesatare është mirë nëse është rezultat real, sepse rezultati po vjen duke rënë në

shkollat e mesme. Rezultatet e arritura të sukseseve mësimore në shkollat fillore ka nevojë për një analizë, për me ditur përse ky rezultat i arritur po pëson rënie në shkollat e mesme.

z. Nexhat Loku, Sa i përket rezultatit të nxënësve në shkolla fillore, unë jam vet arsimtar dhe kur nxënësit në ciklit klasor dinë të gjithë mirë shkrim dhe lexim, atëherë ke me i notuar me notë të larë. Të mosvijueshmëria e mësimi të 13 nxënësve të shkollave fillore, kjo është shqetësuese, ndërkaq më intereson të di, a është paraparë me u marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, pasi që mësimi në shkollat fillore është obligativ. Një nxënës që nuk vijon mësimin është në SHF të f. Kotlinë, në shkollën ku punoj unë.

Kryesuesi i Kuvendit, Është e vërtetë se shkollat në komunën tonë e ngritin ngapak nivelin e notave. Kjo nuk është mirë, sepse më vonë të njëjtit nxënës kur po i nështrohen vlerësimeve të testeve ndërkombëtare, po pësojnë. Shqetësuese është ulja e numrit të nxënësve si rezultat i migrimit jashtë vendit apo regjistrimit në shkolla të komunave tjera. Në informatë është gjendja reale e paraqitur, dy shkolla janë përruruar në këtë periudhë dhe dy shkolla tjera janë në përfundim e sipër.

z. Zahir Doda, Fillimisht ju falenderoj për vlerësimin tuaj në këtë informatë. Në informatë është paraqitur gjendja reale e shkollave. Shqetësimet e juaja për numrin e madh të mungesave të nxënësve dhe arsimtarëve i kemi edhe ne. Këtë çështje sa herë e kemi diskutuar në takimet të cilat i kemi me drejtorët e shkollave. Çështja është se, si DAK kur kemi mungesa të arsyeshme të arsimtarëve, nuk mundemi me i bërë lehtë zëvendësimet e arsimtarëve që mungojnë. Pa konkurs nuk mundemi me bërë asnjë zëvendësim, ndërkaq së paku një muaj e gjysmë na i merr çështja e zëvendësimit të një arsimtari në bazë të konkursit. Sa i përket investimeve në shkolla, investime ka pasur në këtë sektor. Sa i përket hapësirave shkollore për kabinete, shumë shkolla nuk kanë hapësira, ndërkaq mjete buxhetore ka. Të Gjimnazi” Skënderbeu” iu njoftoj se shumë shpejt do të fillojë ndërtimi i aneksit shkollor.

Kryesuesi i Kuvendit, Të shkolla fillore në f. Doganaj nuk ka kontejner. Në këtë drejtim organet relevante duhet marrin veprime të nevojshme me zgjidhur këtë çështje e më i marrë mbeturinat në atë shkollë.

Meqë nuk ka kush diçka, atëherë a jeni që ky kjo informatë të shkojë në procedurë të KK. KPF u pajtuan njëzëri që këtë informatë t’ia kalojnë KK në procedurë për shqyrtim. Në sajë të kësaj del konstatimi se,

KPF e shqyrtoj Informatën e DAK për përfundimin e Periudhës së Parë të Vitit shkollor 2019-2020; dhe e njëjta i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.

5. Propozim Vendimi për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, MMPH përmes MAPL na e ka kthyer Vendimin e KK për emërtimin e rrugëve lokale pa e shqyrtuar në detaje. Shkresës së MMPH iu ka kundërpërgjigjur DAP me një shkresë e cila shkresë është shqyrtuar në detaje nga Agjencioni Kadastral dhe është vlerësuar se kanë ngelë vetëm dy ndryshime të emërtimeve të cilat duhet bëhen ndryshime. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin. Për diskutim nuk u

paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-36179/19 i datës 29.11.2019 - për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e komunës së Kaçanikut; dhe i njëjti i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Plani strategjik i veprimit të Grupit të Grave për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Është një Plan vjetor që është propozuar nga Grupi i grave të KK, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Planin e Punës së Grupit të Grave dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës në Procedurë për shqyrtim dhe aprovim.

7. Plani vjetor i punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk ka kush, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për me ia kaluar KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Planin e Punës së KKSB për vitin 2020 dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës në procedurë të KK për shqyrtim dhe aprovim.

8. Raport (Informatë) i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, A ka kush diçka në këtë raport pune? Nëse jo, atëherë a jeni të pajtimit të ia kalojmë KK këtë raport pune në procedurë për shqyrtim? KPF u pajtua njëzëri që ky raport pune t'i kalohet KK për shqyrtim. Në sajë të kësaj del konstatimi së,

KPF Raportin (Informatë) e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019 ia adreson KK në procedurë për shqyrtim.

9. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Është një Plan pune i këtij komiteti për periudhën e anëtarimit të tyre, të cilët vetëm për tre muaj kanë bërë shumë punë. Nëse ka kush diçka e hapi

diskutimin: Për diskutim nuk ka kush, atëherë a jeni që ky raport pune t'i kaloj KK për shqyrtim dhe aprovim.

KPF u pajtua njëzëri që ky raport pune t' kalojë në procedurë të KK për shqyrtim dhe aprovim. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2019; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:40. Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 31 Janar 2020, në ora 11:00.

Procesmbajtës

Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Mërseli

